

# Komunikojmë

Buletin tremujor mbi projektet për sistemin e drejtësisë në Shqipëri

KORRIK – SHTATOR 2013

NUMRI 11

## NË KËTË NUMËR:

### VEPRIMTARITË NË KORRIK – SHTATOR 2013

Përmirësimi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe funksionimit të gjykatave	1
Regjistrimi Dixhital Audio shtrihet në më shumë gjykata shqiptare	2
Trajnimi i parë rajonal për prokurorët e vendeve të Ballkanit Perëndimor	2
Hapa të mëtejshme në kuadër të Rrjetit të Prokurorëve	2
Mbështetje në fushën e IT-së për Prokurorinë e Përgjithshme të Shqipërisë	2
Fillon punën projekti PAMECA IV	2
Krijohet Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve	3
Dy nënprojekte të reja në kuadër të ORF-LR	3
Raport mbi Kushtet në Burgjet Shqiptare dhe Rekomandimet për Reforma	3
Vizitë studimore për lektorët e Programit Master për Shërbimin e Provës	3
Manuali i përditësuar si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje	3
Mbështetje përmes granteve për nisma antikorrupsion dhe mirëqeverisje nga shoqëria civile	4

### VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË TETOR – DHJETOR 2013



## NUMRAT E MËPARSHËM

Për t'i lexuar, klikoni ikonat e mëposhtme.



### Të nderuar lexues,

**K**ushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe kadri ligjor i dalë në zbatim të saj garantojnë pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe ndalojnë çdo ndërhyrje në ushtrimin e funksioneve gjyqësore. Sot vendi ynë përballet me nevojën e përgjithshme për rritjen e cilësisë dhe të efikasitetit të pushtetit gjyqësor. Për këtë qëllim kërkohet kualifikimi i vazhdueshëm, serioziteti dhe përkushtimi për garantimin e parimeve të shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Sigurisht, një rëndësi të veçantë ka edhe përmirësimi i imazhit dhe lufta pa kompromis e me vendosmëri ndaj fenomenit të korrupsionit. Këto dhe shumë hapa të tjerët duhet të ndërmerren para këtij momenti të madh historik ku vendi ynë pritet të fitojë statusin e vendit kandidat për në Bashkimin Evropian. Megjithatë, integrimi i vendit tonë në BE dhe në strukturat e tjera ndërkombëtare kërkon medoemos edhe ndërmarrjen e shumë reformave të rëndësishme të cilat do ta bëjnë pushtetin gjyqësor të aftë t'u përgjigjet sfidave të kohës, si dhe të sigurojë zbatimin efikas të normave të së Drejtës Evropiane dhe Ndërkombëtare.

Është me rëndësi të theksohet që vendi ynë ka bërë shumë hapa para dhe ka mundur të vërë në jetë shumë reforma të cilat përmirësojnë dukshëm mirëfunksionimin e pushtetit gjyqësor. Këtu mund të përmendim krijimin e një sistemi të drejtësisë administrative, ndryshimin e një sërë ligjesh të cilat bëjnë të mundur rritjen e shpejtësisë së gjykimit të çështjeve, lehtësinë e zbatimit të vendimeve gjyqësore, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, uljen e kostove, lehtësimin e qasjes në drejtësi, rritjen e përgjegjshmërisë dhe transparencës së gjyqtarëve etj. Këto reforma janë fryt i dëshirës dhe përpjekjeve të vazhdueshme të vendit tonë, por edhe i ndihmës bujare e të pazëvendësueshme teknike dhe financiare që kanë dhënë partnerët dhe miqtë tanë ndërkombëtarë. Midis të cilëve një ndihmë e vazhdueshme dhe e qenësishme është mundësuar nga USAID dhe projekti JuST.

Tashmë reformat që po zbatohen dhe që pritet të bëhen në vijim në lidhje me sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve, rritjen e cilësisë së arsytimit të vendimeve gjyqësore, thellimin e njohjes së normave dhe standardeve ndërkombëtare, rritjen e besimit të publikut ndaj drejtësisë, forcimin e rolit të Konferencës Gjyqësore Kombëtare si një Kuvend i Gjyqësorit Shqiptar, rritjen e transparencës dhe forcimin e luftës ndaj korrupsionit etj., janë disa nga prioritetet kryesore për të cilat do të jetë e nevojshme ndihma teknike dhe financiare e partnerëve dhe miqve tanë ndërkombëtarë.

### Sinqerisht,

**Prof. Dr. Xhezair Zaganjori**  
Kryetar i Gjykatës së Lartë

## VEPRIMTARITË NË KORRIK – SHTATOR 2013

### Përmirësimi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore dhe funksionimit të gjykatave

**S**ipas gjetjeve të një studimi të fundit me titull “Drejt drejtësisë” nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, problemi i numrit të pamjaftueshëm të sallave të gjyqit në gjykatat shqiptare ndërlkohet nga fakti se shumica e seancave të planifikuara ose shtyhen ose janë joproduktive.

Në vijim të Konferencës Kombëtare të Lidershit të Gjyqësorit në maj 2013, projekti JuST i USAID-it dhe Prezenca zhvilluan një takim me Kryetaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, të përzgjedhur si gjykatë pilote, për të planifikuar punën e përbashkët në futjen e praktikave të menaxhimit aktiv të çështjeve nga gjyqtarët, ku përfshihen përmirësimi i punës gjatë fazës përgatitore dhe zbatimi më i mirë i parimit që çdo seancë gjyqësore të jetë produktive. Gjatë verës u mblodhën dhe

analizuan të dhëna bazë nga çështje të mbyllura në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë mbi një sërë aspektesh duke përfshirë numrin e seancave për çështje si dhe arsyet për shtyrjet. Ato do të shërbejnë si bazë për vlerësimin e zbatimit të projektit pilot. Përveç përmirësimit të efektshmërisë në gjykatën pilot, kjo përvojë pritet të shërbejë dhe si një shembull për të gjitha gjykatat në Shqipëri se ç'është e mundur të realizohet kur ka drejtues të mirë, zbatohen zgjidhje praktike dhe ekziston vullneti politik.

## Regjistrimi Dixhital Audio shtrihet në më shumë gjykata shqiptare

Deri në fund të tremujorit të tretë të 2013-ës, regjistrimi dixhital audio (RDA) i seancave në sallat e gjyqit ishte shtrirë në dy të tretat e të tridhjetë gjykatave shqiptare të shkallës së parë dhe apelit, duke përfshirë dhe ato për krime të rënda. Me mbështetjen e USAID-it, përmes projektit JuST, zbatimi i teknologjisë RDA për krijimin e procesverbaleve fjalë për fjalë të seancave gjyqësore po bëhet një standard i punës në gjykata. Me hyrjen në

fuqi të ndryshimeve më të fundit në Kodin e Procedurës Civile, Ministri i Drejtësisë nxori më 3 shtator 2013, udhëzimin nr. 353 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”, të botuar në Fletoren Zyrtare nr. 149, datë 9 shtator 2013 (e cila gjendet në internet në adresën: [www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)). Ai përditëson udhëzimin e mëparshëm datë 15 qershor 2012. Ministria e Drejtësisë përcakton përdorimin e sistemit dixhital të regjistrimit audio në gjykatat shqiptare dhe ngarkon kancelarët të raportojnë periodikisht për ecurinë e zbatimit të udhëzimit në fjalë.

## Trajnimi i parë rajonal për prokurorët e vendeve të Ballkanit Perëndimor

Trafikimi i Qenieve Njerëzore dhe Drogave të Paligjshme dhe Ndihma Juridike Ndërkombëtare” ishin çështjet kryesore të trajtuara nga katër ekspertë ndërkombëtarë gjatë trajnimit dyditor të organizuar në ambientet e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA) në Danilovgrad, në datat 26 dhe 27 shtator 2013. Në këtë trajnim morën pjesë prokurorë nga Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi. Trajnimi u organizua nga projekti “Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit

të Prokurorëve”, i financuar nga BE IPA 2010 dhe i zbatuar nga GIZ dhe Qendra për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (CILC). Ai u zhvillua në kuadër të zbatimit të modulit të trajnimeve, i cili përfshin dy trajnime kombëtare për secilin shtet dhe pesë trajnime rajonale.



*Nga trajnimi rajonal për prokurorët në ReSPA, Danilovgrad - Mali i Zi, 26 - 27 shtator 2013.*

## Mbështetje në fushën e IT-së për Prokurorinë e Përgjithshme të Shqipërisë

Një mision me dy ekspertë holandezë të IT-së u organizua nga projekti BE IPA 2010 “Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve”,

gjatë muajit korrik 2013, për të vlerësuar nevojat e Zyrës për Ndihmë Juridike Ndërkombëtare në Prokurorinë e Përgjithshme shqiptare. Ekspertët zhvilluan takime të ndryshme me përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe Ministria e Drejtësisë dhe dolën me një raport. Një vendim mbi këtë çështje pritet të merret së shpejti.

## Krijohet Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve

Mbledhja e asamblesë së përgjithshme të ndërmjetësve të licencuar dhe të regjistruar në organet tatimore shqiptare, e cila u mbajt në 7 korrik 2013, vendosi krijimin e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve (DHKN) në Shqipëri. Në këtë mbledhje u zgjodh dhe Kryesia e përbërë nga 7 anëtarë dhe Kryetare, Znj. Drita Avdyli, të cilët kanë punuar ndërkohë me intensitet për formulimin e kodit të etikës, përcaktimin e tarifave të shërbimit dhe të atyre të

anëtarësisë në DHKN, si dhe ngritjen e dhomave rajonale të ndërmjetësve siç parashikohet në ligjin shqiptar për ndërmjetësimin. Projekti JuST i USAID-it do të ofrojë mbështetje për forcimin e kapaciteteve organizative të Dhomës dhe për këtë qëllim ka nxjerrë një kërkesë për aplikime nga organizata të shoqërisë civile në kuadrin e programit të tij të granteve.



*Logoja e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve në Shqipëri e krijuar rishtazi.*

## Hapa të mëtejshme në kuadër të Rrjetit të Prokurorëve

Pas takimit të Rrjetit të Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Korfuz, Greqi, në 9 maj 2013, projekti BE IPA 2010 “Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve” organizoi një tjetër takim në Budva, Mali i Zi, në 24 - 25 shtator 2013, me fokus rishikimin e Memorandumit ekzistues të Bashkëpunimit të këtij Rrjeti. Janë zhvilluar dhe pranuar dy variante të Memorandumit të rishikuar që aktualisht po qarkullojnë midis përfituesve për miratim. Duhet theksuar se pjesëmarrës në këto takime kanë qenë edhe përfaqësues të Rrjetit Gjyqësor Evropian (EJN). Pjesëmarrja e tyre mbështet integrimin e Rrjetit të Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare.

## Fillon punën projekti PAMECA IV

Projekti “Konsolidimi i Kapaciteteve të Zbatimit të Ligjit në Shqipëri”, PAMECA IV, i financuar nga BE-ja, ka filluar në qershor 2013. Projekti do të mbështesë Ministrinë e Brendshme, Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë e Përgjithshme të Shqipërisë si përfituesit kryesorë, me qëllim rritjen e performancës së tyre në luftën kundër veprimtarive kriminale në përputhje me praktikat më të mira të BE-së. Projekti zbatohet nga Ministria e Brendshme italiane si partner kryesor, në konsorcium me Ministrinë e Brendshme të Francës dhe Ministrinë e Brendshme Federale të Austrisë. PAMECA IV do të vazhdojë deri në tetor 2016. Synimi i përgjithshëm i projektit është që të asistojë për të afuar kapacitetet e zbatimit të ligjit në institucionet shqiptare më pranë standardeve të BE-së në fushën e policisë duke i dhënë qytetarëve shqiptarë besim, siguri dhe një ambient të sigurt. Objektivat e tij specifike janë përmirësimi i kapaciteteve të burimeve organizative, administrative, teknike dhe menaxhuese të strukturave të Policisë së Shtetit dhe përmirësimi i performancës së këtyre strukturave dhe i bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme dhe agjencitë e tjera përkatëse. Projekti PAMECA IV drejtohet nga Z. Giorgio Butini, Lejtnant-Kolonel i Policisë së Shtetit të Italisë me një eksperiencë të gjatë e të shquar në profesion.

## Dy nënprojekte të reja në kuadër të ORF-LR

Në fazën e dytë të projektit të Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Reforma Ligjore (ORF-LR) nga GIZ, qeveria gjermane vazhdon të mbështesë zbatimin e metodave alternative të zgjidhjes së konflikteve dhe forcimin e Rrjetit të Shkollave Juridike të Evropës Juglindore (SEELS).

Zbatimi i mjeteve alternative për zgjidhjen e konflikteve (ADR) i orientuar nga barazia gjinore në Ballkanin Perëndimor” është nisma e re e GIZ ORF-LR. Kësaj here GIZ vjen me një fokus më të madh drejt arritjes së barazisë gjinore. Një nga qëllimet kryesore të nënprojektit është

promovimi i juristeve femra dhe forcimi i pozitave të tyre si aktore në procedurat e ADR-së. Gjatë periudhës së zbatimit (shtator 2013 - mars 2015), një pikë tjetër e rëndësishme do jetë mbështetja e rajonit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkufitare për çështjet tregtare duke u bazuar në standardet ndërkombëtare. GIZ-i nuk do të punojë i vetëm. Përveçse me partnerët rajonalë (qendrat ADR, universitetet, ministritë e drejtësisë etj.), një bashkëpunim i rëndësishëm është vendosur me partnerë ndërkombëtarë, si ArbitralWomen, Institucioni Gjerman i Arbitrazhit (DIS) dhe UNCITRAL.

Rrjeti i Shkollave të Drejtësisë në Evropën Juglindore (SEELS) është themeluar si një rrjet i formalizuar dhe i institucionalizuar i

trembëdhjetë fakulteteve publike të drejtësisë nga Evropa Juglindore në 25 mars 2011. SEELS prezantoi një formë të re të bashkëpunimit akademik rajonal dhe një platformë për një edukim ligjor, kërkime shkencore dhe publikime të intensifikuara. GIZ-i do të mbështesë zhvillimin strategjik të SEELS-it deri në shtator 2014. Qëllimi kryesor i projektit është forcimi i strukturave operacionale dhe i pozicionimit strategjik të Rrjetit për të kontribuar në reformat ligjore në rajon. Projekti do të fokusohet në zbatimin e programeve të përbashkëta rajonale, forcimin e kapaciteteve të SEELS-it për të përfituar nga grantet e BE-së, zhvillimin dhe adaptimin e dokumenteve strategjike të tij, si edhe publikime. Grupet përfituese të projektit janë fakultetet e drejtësisë, anëtarë të SEELS-it.

## Raport mbi Kushtet në Burgjet Shqiptare dhe Rekomandimet për Reforma

Në shtator 2013, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri nxori një raport mbi Kushtet në Burgjet Shqiptare dhe Rekomandimet për Reforma. Prezenca vizitoi njëmbëdhjetë nga njëzet e dy burgjet në vend në fund të vitit 2012 për të kryer intervista dhe për të bërë vëzhgime. Nga rekomandimet e shumta në këtë raport, disa që përbëjnë shqetësim të veçantë përfshijnë rinovime të cilat nevojiten urgjentisht në objekte të caktuara, rëndësinë e hetimit të akuzave për korrupsion nga ana e personelit mjekësor dhe nevojën e sigurimit të pajisjeve

të specializuara dhe kujdesit për njerëzit me sëmundje mendore. Një nga gjetjet në Raport ishte mungesa e një praktikë të qëndrueshme për informimin e të paraburgosurve mbi të drejtat e tyre pas futjes në një ambient paraburgimi. Për të ndihmuar në adresimin e këtij problemi, Prezenca, në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, botoi dhe shpërndau një broshurë në shtator 2013. Kjo broshurë u jep personave të paraburgosur informacion për të drejtat e tyre gjatë qëndrimit në burg dhe në paraburgim si dhe shpjegon gjithashtu detyrimet e tyre në regjimin e burgut. Së fundi, broshura ofron informacion për kontaktimin e Avokatit të Popullit në mënyrë që personat e ndaluar të dinë si të raportojnë kur keqtrajtohen.

## Vizitë studimore për lektorët e Programit Master për Shërbimin e Provës

Si pjesë e projektit për krijimin e një programi Master me titull “Administrimi i institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë”,



Alba Jorganxhi (djathtas) nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri shoqëron lektorë të Programit Master për Shërbimin e Provës në një vizitë studimore te Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në Turqi, Ankara, 18 shtator 2013.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri organizoi një vizitë studimore për ekipin prej gjashtë lektorësh tek Universiteti “Turgut Ozal” në Ankara, në 16 - 19 shtator 2013. Vizita studimore kishte për qëllim rritjen e cilësisë së plan-programeve dhe metodave të mësimdhënies, duke i prezantuar lektorëve përvojat e Universitetit “Turgut Ozal” në ofrimin e programeve të ngjashme Master. Gjatë vizitës studimore, disa lektorë si dhe ekspertë nga fusha e burgjeve, shërbimit të provës dhe institucioneve të drejtësisë diskutuan me ekipin shqiptar praktikata më të mira. Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve në Turqi ashtu si edhe Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës pritën lektorët shqiptarë. Pjesëmarrësit vizituan një institut të hapur edukativ për autorët e mitor të veprave penale, i cili vuri në dukje rëndësinë e ekuilibrit midis ndëshkimit, rehabilitimit dhe ri-integrimit në dënimet penale.

## Manuali i përditësuar si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje

Në shtator 2013, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri prezantoi një botim të përditësuar të Manualit të saj se si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje duke reflektuar ndryshimet e kuadrit ligjor si dhe në përgjigje të kërkesave të atyre që punojnë me viktimat e dhunës në familje. Manuali, i cili është një udhëzues praktik i përgatitur në një gjuhë të qartë që ndihmon viktimat të kërkojnë mbrojtje ligjore, ka tashmë më shumë se gjashtë vjet që është në përdorim. 3500 kopje të versionit të përditësuar po u shpërndahen organizatave dhe autoriteteve qendrore dhe lokale, të cilat ndihmojnë viktimat e dhunës në familje.



Manuali i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, “Si të kërkojmë mbrojtje nga dhuna në familje”, 2013.



## Mbështetje përmes granteve për nisma antikorrupsion dhe mirëqeverisje nga shoqëria civile

Në 20 shtator 2013, përfaqësues të nëntë organizatave të shoqërisë civile (OSHC) që janë përfituese të deritanishme të granteve nga projekti JuST i USAID-it, prezantuan para përfaqësuesve nga OSHC

të tjera, institucione të drejtësisë e donatorë, rezultatet e projekteve të ndërmarra nga to në fushën e mirëqeverisjes dhe antikorrupsionit. Në takim morën fjalën dhe përfaqësues të përfituesve: gra të dhunuara që kanë marrë ndihmë ligjore falas në Elbasan dhe Shkodër; gazetarë investigativë të trajnuar; studentë të drejtësisë të Universitetit të Tiranës që kanë ofruar informacion dhe ndihmë ligjore për publikun pranë gjykatave, anëtarë të

komuniteteve të angazhuara në zbatimin e projekteve etj. Takimi ofroi një mundësi shumë të mirë për të ndarë informacion mbi sukseset dhe praktikat më të mira në mbështetje të nismave antikorrupsion dhe për mirëqeverisje, përgjegjshmëri dhe transparencë nga OSHC-të në gjyqësor dhe në përgjithësi në Shqipëri. Më shumë informacionin për programin e granteve të projektit JuST të USAID-it gjendet në adresën: [www.justforumalbania.org](http://www.justforumalbania.org).

## VEPRIMTARITË E PARASHIKUARA NË TETOR – DHJETOR 2013

- Vizitë studimore “Mbi hetimet financiare” për prokurorët nga Shqipëria dhe Kosova në Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm të Zvicrës, Bernë, BE IPA 2010 “Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve”, 8 - 11 tetor 2013
- Trajnimi rajonal mbi Teknikat e Hetimit dhe Mbledhjes së Provave në Çështjet Ndërkufitare të Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Cavtat - Kroaci, BE IPA 2010 “Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit: Forcimi i Rrjetit të Prokurorëve”, 21 - 22 tetor 2013
- Ceremonia zyrtare e fillimit të projektit PAMECA IV, “Konsolidimi i Kapaciteteve të Zbatimit të Ligjit në Shqipëri”, PAMECA IV, tetor 2013
- Botimi i numrit të 8-të të revistës juridike “Avokatia”, Dhoma Kombëtare e Avokatisë me mbështetjen e USAID JuST, tetor 2013
- Trajnim për gjyqtarët e sapoemëruar në gjykatat administrative mbi risitë procedurale të Ligjit për Gjykatat Administrative, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, tetor 2013
- Vizitë studimore për ekipin e lektorëve të programit Master “Administrimi i institucioneve sociale në sistemin e Drejtësisë”, në Utreht - Holandë, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 11 - 15 nëntor, 2013
- Konferenca e Tretë Rajonale e Liderimit në Gjyqësor për të ndarë përvojat në zbatimin e sistemit RDA në gjykatat e zonës së apelit Tiranë si dhe ato për krime të rënda, USAID JuST, 13 - 15 nëntor 2013
- Takimi inauguroes i nënprojektit “Zbatimi i mjeteve alternative për zgjidhjen e konflikteve (ADR) i orientuar nga barazia gjinore në Ballkanin Perëndimor”, Budva - Montenegro, GIZ ORF-LR, 15 nëntor 2013
- Përfundimi i shtrirjes së teknologjisë së regjistrimit dixhital audio në zonën e apelit Vlorë, i cili pason atë të Korçës, Durrësit dhe Tiranës, si dhe në shkallën e parë dhe apelin për krime të rënda, USAID JuST, nëntor 2013
- Përrurimi i ambienteve të reja të klinikës ligjore, duke përfshirë dhe një sallë gjyqi imitues, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, rikonstruktuar me mbështetjen e USAID JuST, nëntor 2013
- Trajnim për oficerët e shërbimit të provës lidhur me trajtimin e autorëve të mitur të veprave penale, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, tetor - nëntor 2013
- Mbledhje pune me gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë mbi efikasitetin e seancave gjyqësore dhe menaxhimin aktiv të çështjeve, e bashkorganizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe USAID JuST, dhjetor 2013
- Tryezë e rrumbullakët me avokatë mbrojtës për çështje lidhur me shërbimin e provës, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, dhjetor 2013
- Vlerësim në vazhdimësi i koncept-ideve për marrje granti nga OSHC, i propozimeve të plota që rrjedhin nga to, ashtu si dhe i aplikimeve në përgjigje të kërkesave për propozime lidhur me ndërgjegjësimin dhe avokimin mbi sistemin RDA në bazë rajonale, apo për rritjen e kapaciteteve të Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, USAID JuST, tetor - dhjetor 2013



USAID JuST  
E-mail: [office@ajssp.org.al](mailto:office@ajssp.org.al)  
[www.usaid.gov](http://www.usaid.gov)



E-mail: [info@pameca.org.al](mailto:info@pameca.org.al)  
[www.pameca.org.al](http://www.pameca.org.al)



Prezenca e OSBE-së në Shqipëri  
E-mail: [pm-al@osce.org](mailto:pm-al@osce.org)  
[www.osce.org/albania](http://www.osce.org/albania)



E-mail: [orflex-al@giz.de](mailto:orflex-al@giz.de)  
[www.giz.de](http://www.giz.de)



GIZ ORF-LR  
E-mail: [thomas.meyer@giz.de](mailto:thomas.meyer@giz.de)  
[www.giz.de](http://www.giz.de)

## Shprehjet e falënderimit dhe mbi përgjegjësitë

Artikujt e këtij buletini janë kontribute të projekteve të donatorëve të cilët mbështesin aktivisht reformën në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Kontribuuesit mbajnë përgjegjësi të plotë për përbajtjen e artikujve të tyre, të cilat nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorëve apo qeverive përkatëse.